



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-086
Prishtinë, më 23 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përcaktuar me vendim të Kuvendit, datë 22 dhjetor 2016.

Ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet e parlamentare, mbështetur në vendimin e Kuvendit, datë 22 dhjetor 2016, e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Naser Osmani, diskutimi i të cilit është i plotë në transkript.

Për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 diskutoi edhe nënkryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, diskutimi i të cilës është i plotë në transkript

Në këtë projektligj ishin paraqitur 60 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet nga 1 deri 28 përnjëherë, të cilat i miratoi Kuvendi.

Pastaj, kryetari i hodhi një nga një në votim amendamentet tjera, ngase për një amendament kishte nga dy propozime.

Kuvendi i miratoi edhe amendamentet tjera, si në vijim: 31, të propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu dhe 54, të propozuar nga deputetja Time Kadrijaj.

Deputeti Armend Zemaj i tërhoqi amendamentet 34, 35, 36 dhe 37.

Deputetja Duda Balje i tërhoqi amendamentet 38 dhe 39.

Deputeti Pal Lekaj e tërhoqi amendamentin 41.

Deputeti Bali Muharremi i tërhoqi amendamentet 42 dhe 43.

Deputeti Enver Hoti i tërhoqi amendamentet 51 dhe 52.

Deputetja Time Kadrijaj i tërhoqi amendamentet 55 dhe 56.

Deputeti Bekim Haxhiu i tërhoqi amendamentet 58 dhe 59.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 29, 30, 32, 40, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 53, 57 dhe 60.

Në fund, kryetari e hodhi në votim tekstin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vë vijim:

Për ----- 70,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Ligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 01:30 minuta

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*